



Datë: 16 Janar 2024

TERMA REFERENCE

PËR SHËRBIM FINANCIAR

1. HYRJE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri (QDGJSH) është një organizatë jofitimprurëse, e pavarur, jopolitike, e cila punon për fuqizimin e grave dhe vajzave, mbron të drejtat e tyre dhe lufton pabarazitë gjinore. QDGJSH është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë më datë 28/06/2022 me vendimin nr. 1738. Sipas legjislacionit në fuqi, QDGJSH është regjistruar gjithashtu pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Tiranë me nr. NIPT: M22002451K.

Misioni i Qendrës është të kontribuojë për krijimin e një shoqërie ku të gjitha gratë të jetojnë një jetë me dinjitet, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.

Qasja e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, është:

- Të punojë për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, rritjen e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare rreth të drejtave të grave dhe çështjeve gjinore;
- Të mbështesë gratë dhe vajzat për të rritur pjesëmarrjen dhe influencën e tyre në jetën sociale, ekonomike dhe politike të vendit nëpërmjet zbatimit të programeve të lidershit, rritjes së aftësive profesionale, etj.;
- Të adresojë nevojat e grave dhe vajzave viktime të dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve direkte me qëllim fuqizimin e tyre social dhe ekonomik;
- Të rrisë kapacitetet e punonjësve të institucioneve shtetërore dhe jo-shtetërore që punojnë për mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për gra dhe vajza;
- Të advokojë dhe llojojë për respektimin e të drejtave të grave dhe arritjen e drejtësisë gjinore në shoqërinë shqiptare;
- Të kryejë studime, analiza dhe kërkime rreth çështjeve gjinore, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje.

2. INFORMACION MBI SHËRBIMIN E KËRKUAR

Qendra për Drejtësi Gjinore po zbaton projektin “Informim dhe mbështetje direkte për viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Lushnjë” në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor 2 (ReLOaD2), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të kontrakttojë një financier për ofrimin e shërbimit gjatë periudhës 1 Shkurt – 31 Tetor 2024.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË KRYESORE

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
Rr. "Nikolla Tupe", P. 352, Tiranë, Shqipëri

Web: www.gjalbania.org; E-mail: genderjusticealbania@gmail.com; Tel: +355692667531



- Të menaxhojë shpenzimet e projektit sipas politikave financiare të organizatës dhe kërkesave të donatorit;
- Të kryejë të gjitha transaksionet financiare (transfera bankare, cash apo çek) të parashikuara në projekt në përputhje me legjislacionin në fuqi, rregullat e prokurimit, rregulloret përkatëse të donatorit, Kodit të Punës dhe kërkesave të auditit;
- Të regjistrojë dhe të mbajë dokumentacionin e arkës, bankës dhe të gjithë dokumentacionin mbështetës financiar sipas shpenzimeve, kërkesave të organizatës dhe donatorit;
- Të kryejë brenda afateve dhe me korrektësi të gjitha deklaratimet sipas legjislacionit në fuqi;
- Të përgatisë raportet financiare sipas kërkesave të organizatës dhe donatorit;
- Të respektojë afatet e vendosura për kryerjen e pagesave/transaksioneve dhe dorëzimin e raporteve financiare;
- Të mbajë kontakte dhe bashkëpunim korrekt me stafin/konsulentët e përfshirë në projekt dhe donatorin;
- Të tregojë korrektësi në zbatimin e orareve dhe afateve të cilat janë vendosur paraprakisht;
- Të respektojë me rigorozitet rregullat e konfidencialitetit në organizatë.

4. KUALIFIKIME DHE AFTËSI TË KERKUARA

- Diplomë universitare në Ekonomi (preferohet Dega Financë);
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Të ketë njohuri shumë të mira të legjislacionit dhe rregulloreve mbi veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse si dhe të subjekteve fitimprurëse;
- Të jetë i/e motivuar dhe fleksibël me ngarkesën e punës;
- Të jetë sistematik/e në punë dhe të ketë njohuri në ruajtjen e dokumentacionit financiar;
- Të ketë njohuri të programit Alpha;
- Preferohet të ketë eksperiencë pune të mëparshme me organizata të shoqërisë civile;
- Të zotërojë aftësi shumë të mira komunikuese;
- Të jetë bashkëpunues/e, me qasje pozitive dhe etikë profesionale.

5. PROCESI I APLIKIMIT

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë me shkrim në adresën elektronike ose adresën postare të Qendrës për Drejtësi Gjinore dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Curriculum Vitae;
- Letër motivimi;
- Ofertë financiare për shërbimin e kërkuar (kosto për ditë pune).

Adresë elektronike: genderjusticealbania@gmail.com; adena.vangjeli@gjalbania.org

Adresë postare: Rr. "Nikolla Tupe", P. 352, Ap. 3, Tiranë, Shqipëri.

6. AFATET

Afati për dërgimin e aplikimeve: 19/01/2024, ora 17:00

Njoftimi i aplikantëve që kalojnë në fazën e dytë të përzgjedhjes (intervistë): 23/01/2024

Njoftimi mbi përzgjedhjen: 26/01/2024.